



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Terma Reference

Pozicioni:	Ekspert i jashtëm për përgatitjen e një modeli ndërhyrjeje drejt riintegritimit dhe rehabilitimit të grave/nëna në prag lirimi
Projekti:	Ofrimi i mbështetjes psikosociale dhe qasjes riintegruese nga agjensitë ligjzbatuese për gratë e privuara në prag lirimi dhe tek të miturit recidivist
Bashkia:	Tiranë
Lloji i kontratës:	Kontratë Shërbimi

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të punësojë një ekspert të jashtëm për përgatitjen e një modeli ndërhyrjeje drejt riintegritimit dhe rehabilitimit të grave nëna të privuara nga liria, pjesë e programit “Ofrimi i mbështetjes psikosociale dhe qasjes riintegruese nga agjensitë ligjzbatuese për gratë e privuara në prag lirimi dhe tek të miturit recidivist”, zbatuar nga organizata TLAS dhe financuar nga Bashkimi Evropian.

Informacion i Përgjithshëm

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht Nisma) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të margjinalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbimit ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Background

Ligji shqiptar nr. 8328/1998, neni 55 (pika 1 dhe 2 [3]) dhe neni 86 (pika 2 / i [4], neni 133 pika 1 [5], thotë se "jo më vonë se 6 muaj para lirimi, stafi i burgut duhet të zhvillojë një program specifik të individualizuar në bashkëpunim me aktorë të tjerë dhe OJQ-të që punojnë në terren, i cili fokus kryesor është parandalimi i recidivizmit, ndihma sociale dhe psikologjike, trajnimet profesionale, aftësitë arsimore dhe aftësitë e tjera të lidhura me punën, për të ndihmuar gratë të përgatiten për riintegrim në jetën e komunitetit dhe përballjen me vështirësitë e përmendura më lart. Pavarësisht nga fakti që një pjesë e procesit të ri-integrimit është e rregulluar nga ligji, akoma mungojnë shumë nga elementët e mësipërm që ofrojnë mbështetje të mëtijshme për gratë pas largimit nga burgu. Modelet që ofrojnë udhëzime për praktikën e ndërhyrjes mungojnë gjithashtu në kontekstin shqiptar.



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

Në konsultim me sektorin shoqëror të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Burgu i Grave) është dakordësuar nevoja për protokolle për riintegrimin e grave në mënyrë specifike grave/nënave të privuara nga liria në mënyrë që të pajisë profesionistët e sektorit social me mjetet e duhura për identifikimin e nevojave, trajtimin dhe përgatitjen për planin individual të trajtimit dhe menaxhimit e rasteve të grave/nënave para se të dalin nga burgu dhe kthimin në komunitet.

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i kësaj ekspertize është të qartësojë nëpërmjet zhvillimit të një protokollit për menaxhimin e rasteve të grave/nënave të privuara nga liria në prag lirimit dhe përgjegjësitë e profesionistëve të sektorit social duke orientuar punën e tyre nëpërmjet formave dhe teknikave në kuadër të procesit të menaxhimit të rasteve.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Eksperti do të realizojë një protokoll pune për riintegrimin/rehabilitimin e grave/nënave të privuara nga liria, të cilat janë në prag lirimit, jo më shumë se 6 muaj nga lirimimi i plotë.

Eksperti me mbështetjen e organizatës pritet:

- Përgatitja e metodologjisë që do të ndiqet për përfshirjen e palëve të interesit në përgatitjen e Protokollit.
- Organizimi i fokus grupeve, intervistave dhe takimeve për zhvillimin e Protokollit.
- Mbajtjen e kontakteve me institucionet e përfshira në këtë proces si Drejtoria e Burgjeve, IEVP Ali Demi, Shërbimi Social i Bashkisë Tiranë dhe palëve të tjera të interesit.
- Takim konsultues me Drejtorinë e Burgjeve, Shërbimin Social dhe Institucione të tjera të përfshira në kornizën mbështetëse për riintegrimin dhe rehabilitimin e grave/nënave në prag lirimit.
- Përcaktimi i burimeve të nevojshme për ndjekjen e hapave të protokollit, (njerëzore, materiale, logjistike dhe financiare).
- Përfshirja e profesionistëve dhe palëve të interesit që do të ofrojnë opinionin e tyre gjatë draftimit të protokollit.

Eksperti do të dorëzojë:

- a) Metodologjinë e hartimit të planit të punës;
- b) Draft Protokollin e riintegrimit/rehabilitimit të grave/nënave në prag lirimimi;

Kualifikime dhe eksperiencia e punës

- Diplomë universitare e ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e shkencave sociale.
- Njohuri shumë të mira dhe eksperiencë të mëparshme në hartimin e protokolleve apo udhëzimeve të grupeve vulnerabël drejt riintegrimit/rehabilitimit apo dokumentave të ngjashëm.
- Njohuri shumë të mira të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 dhe të gjithë paketës ligjore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Më tepër se 5 vite eksperiencë profesionale si ekspert, dhe praktikë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, kryesisht në menaxhimin e rasteve dhe fuqizimin e familjeve në situatë vulnerabël;



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

- Përvojë me koordinimin e veprimeve për realizimin e raporteve, manualeve dhe analizave në fushën e mbrojtjes sociale

Afatet kohore

Dorëzim i metodologjisë	30 Nëntor 2020
Dorëzimi i draftit të parë të protokollit	15 Dhjetor 2020
Dorëzimi i dokumentit final të protokollit	30 Dhjetor 2020

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

Procedura e Aplikimit

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dërgojnë me email CV-në e tyre, një draft të parë të metodologjisë së propozuar bashkë me planin e punës dhe një letër interesi për NISMA në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën **25.11.2020**, mesnatë.

Procedura e Vlerësimit

Zgjedhja e personit do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	20%
Eksperiencë pune	50%
Intervista	30%

**Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët për pozicionin e ekspertit do të kontaktohen.*